



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:082158
Datë: 17.10.2024
Numri i dokumentit: 06315858

PPP.nr.108/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike të kreditorit Iute Credit Kosova Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit I. (I.) Z., me adresë në fshati Zh. i P., M., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore me datë 17.10.2024 nxjerr ketë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i debitorit I. (I.) Z., me adresë në fshati Zh. i P., M., i ushtruar kundër urdhërit përmbarues P.nr... i datës ... mbi lejinin e përmbarimit të propozimit për përmbarim të datës ..., në shumën prej ...€
- II. **LIHET** në fuqi urdhërit përmbarimor mbi lejinin e përmbarimit P.nr.... i datës

Arsyetim

Kreditori, Iute Credit Kosova Sh.A me datën ..., ka paraqitur propozimin për përmbarim sipas titullit përmbarimor – Marrëveshjes për kredinë nr.... e datës ... dhe shtojca 1 Marrëveshja mbi pengun, kundër debitorit I. (I.) Z.

Përmbaruesi Privat, me urdhërin përmbarimor P.nr.. i datës ..., ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit Iute Credit Kosova Sh.A.

Kundër këtij urdhëri, debitori në afat ligjor ka paraqitur prapësimin duke i propozuar gjykatës që ta rafuzojë propozimin për përmbarim dhe ta anulojë urdhërin përmbarimor.

Në bazë të nenit 27 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore parashihet që “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”.

Gjykata, vlerëson se dokumenti përmbarimor - Marrëveshjes për kredinë nr.... e datës ... dhe shtojca 1 Marrëveshja mbi pengun, është i përshtatshëm për përmbarim dhe në të janë treguar kreditori, debitori, mjetet, përkatësisht shuma që ka detyrim debitori ku i njëjti ka marrë huanë

në shumën prej ... euro me normë të interesit ... dhe normë efektive të interesit ...%, ndërsa koha e përmbushjes së këtij obligimi e cila ka qenë deri me datën 20.11.2021.

Gjykata, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësim nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohej urdhëri përmbartimor.

Gjykata, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se “*Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore*”, përjashtimisht Gjykata mund të caktoj seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.

Andaj nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 73 të LPP-së, dhe në bazë të argumentimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.108/23, me datë 17.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.